



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-116325
Më 22.08.2017




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës më 22 gusht 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e larjes dhe pastrimit të automjeteve të Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Administratës -mallra dhe shërbime.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës-Sektori Teknik, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-116337
Më 22.08.2017




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës më 22 gusht 2017, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e rindërtimit të çezmës publike “Guska çesme” në rr. “Ejup Statovci” në lagjen Tabakhane në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike -mallra dhe shërbime.
3. Çezmja publike e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi do të jetë në pronësi të Komunës së Prizrenit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Zyrës së Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-116340
Më 22.08.2017



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës më 22 gusht 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e hartimit të Strategjisë zhvillimore të sportit në Komunën e Prizrenit, për periudhën 2017-2020.
2. Strategjia zhvillimore e sportit e Komunës së Prizrenit, për periudhën 2017-2020 , do të hartohet nga Asociacioni i sporteve - Prizrenit në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe subjektet (klubet dhe shoqatat) e ndryshme sportive të Komunës së Prizrenit.
3. Pas hartimit të Draft Strategjisë së lartcekur e njëjta do t'i nënshtrohet procedurave të rregullta ligjore për miratim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvend të Komunës.
4. Për realizimin e kësaj strategjie–projekti, lejohen mjetet financiare në shumën prej 4000.00 € (katërmijë euro).
5. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 4 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-116345
Më 22.08.2017




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës me 22 gusht 2017, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 01/011- 93270 të datës 18 korrik 2017, që ka të bëjë për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pagesën e qirasë për familjen e Sehare Zajmit, banuese në rr. “Bujtina” nr. 5 në Prizren, kështu që, në vend të fjalës “lejohen mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pagesën e qirasë” duhet të jetë si në vijim:
 - 1.1. Lejohen mjetet për mbështetje financiare për familjen e Sehare Zajmit, banuese në rr. “Bujtina” nr. 5 në Prizren.
2. Pjesët tjera të vendimit nr. 01/011-93270 të datës 18 korrik 2017, mbesin të pandryshuara.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të gjitha drejtorive,
 - Arkivës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramdan Muja